



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

Legjislatura IV  
Sesioni pranveror

Mbledhja plenare e Kuvendit  
P-160  
Prishtinë, më 10 prill 2014

**PROCESVERBAL**

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,  
E MBAJTUR MË 10, 11 DHE 17 PRILL 2014**

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, Jakup Krasniqi, ndërsa i ndihmuan nënkryetarët Xhavit Haliti, Albert Kinolli dhe Sabri Hamiti.

Kryetari i deklaroi të hapura punimet e mbledhjes plenare dhe procedoi me rendin e ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

**1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës**

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën deputetët: Ganimete Musliu, Ismet Beqiri, Faton Topalli, Xhevdet Neziraj, Aurora Bakalli, Elmi Reçica, Rita Hajzeraj-Beqaj, Bekim Haxhiu Gëzim Kelmendi dhe ministri Ferid Agani, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

**2. Koha për pyetje parlamentare**

Deputetja Teuta Haxhiu parashtrroi pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi në lidhje me atë se çka kuptohet me koncept planin kombëtar për zhvillimin e zonave ekonomike në Kosovë 2014 – 2018 dhe pse nuk është bërë publik ky plan?  
Kryeministri Hashim Thaçi nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Alma Lama parashtrroi pyetje për ministrin Ferid Agani në lidhje me mungesën e ofrimit të ndihmës nga Ministria e Shëndetësisë për shërimin e vajzës 5-vjeçare të familjes Taholli nga Suhareka.

Ministri Ferid Agani iu përgjigj pyetjes së deputetes Alma Lama.

Deputetja Alma Lama parashtrroi pyetje për ministrin Memli Krasniqi në lidhje me veprimet e Ministrisë së Kulturës për kthimin e mijëra artefakteve dhe dokumentacionit të monumenteve të kulturës nga Serbia, të cilat ndodhen në Muzeun e Krushevcit.

Ministri Memli Krasniqi nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Afrim Hoti parashtrroi pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi në lidhje atë, siç tha ai ndalimin e mjekëve shqiptarë të Komunës së Mitrovicës, për të shkuar në vendet e tyre të punës në pjesën veriore të Mitrovicës, disa vite më parë.

Kryeministri Hashim Thaçi nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Albana Gashi parashtrroi pyetje për ministrin Nenad Rashiq në lidhje me masat e ndërmarra nga Ministria që ai drejton lidhur me dyshimet për abuzime me pacientë të sëmurë mendor në Shtime.

Ministri Nenad Rashiq iu përgjigj pyetjes së deputetes Albana Gashi.

Deputeti Afrim Hoti parashtrroi pyetje për zv./kryeministrin Hajredin Kuçi në lidhje atë se a është duke përgatitur Ministria e Drejtësisë dokumentacionin me dëshmi lidhur me krimet e luftës të shtetit serb në Kosovë?

Zv/kryeministri Hajredin Kuçi nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Faton Topalli parashtrroi pyetje për ministri Nenad Rashiq në lidhje me numrin e pensionistëve në Kosovë të cilëve u ndërpritet pensioni si pasojë e procedurave administrative për paraqitje sipas afateve kohore, për ta konfirmuar se ata janë gjallë.

Ministri Nenad Rashiq iu përgjigj pyetjes së deputetit Faton Topalli.

Deputetja Teuta Haxhiu parashtrroi pyetje për ministrin Mahir Yagcilar në lidhje me vendimin e Qeverisë për rritje të pagave të shërbyesve civilë dhe zbatimin e Rregullores për shtesat në pagë dhe kompensimet tjera për nëpunësit civilë.

Ministri Mahir Yagcilar iu përgjigj pyetjes së deputetes Teuta Haxhiu.

Deputetja Salihe Mustafa parashtrroi pyetje për ministrin Ferid Agani në lidhje me atë se kur do të fillojë zbatimi i nenit 71 të Ligjit për shëndetësinë që ka të bëjë me punësimin në viset rurale të mjekëve të posa diplomuar.

Ministri Ferid Agani iu përgjigj pyetjes së deputetes Salihe Mustafa.

Deputeti Shaip Muja parashtrroi pyetje për ministrin Ferid Agani në lidhje me funksionalizimin e sistemit informativ shëndetësor që ka të bëjë me zbatimin e Ligjit për sigurimin shëndetësor.

Ministri Ferid Agani iu përgjigj pyetjes së deputetit Shaip Muja.

Deputeti Shaip Muja parashtrroi pyetje për ministrin Ferid Agani në lidhje me funksionalizimin sa më të mirë të Repartit të Kardiokirurgjisë në QKUK.

Ministri Ferid Agani iu përgjigj pyetjes së deputetit Shaip Muja.

Deputeti Faton Topalli parashtrroi pyetje për ministri Blerand Stavileci në lidhje me ankesat e fermerëve lidhur me përfitimën e grandeve, sepse siç tha ai, ata detyrohen të japin ryshfet dhe çka është ndërmarr që kjo çështje të ndërpritet.

Ministri Blerand Stavileci nuk ishte i pranishëm në sallë, mirëpo me pajtimin e deputetit Topalli, në këtë pyetje u përgjigjen kryeministri Hashim Thaçi, si dhe ministri Besim Beqaj.

Në vazhdim, Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë:

### **Rend dite**

3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mëparshme,
4. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes së kredisë eksportuese e lidhur ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Unicredit Bank Austria AG për financimin e projektit “Modernizimi i sistemit të arsimit të edukimit në Kosovë nëpërmjet e-edukimit”,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërmarrjet publike,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për kinematografinë,
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për sigurimin shëndetësor,
9. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për arsimin e lartë të Republikës së Kosovës,
10. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për vitin 2013,
11. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e kryesuesit dhe anëtarëve të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës,
12. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Shkencës,
13. Emërimi i anëtarëve të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës,
14. Emërimi i anëtarit të Komisionit për Kërkesa Pronësore,
15. Zgjedhja e një anëtari të Komisionit të Pavarur për Media.

\* \* \*

### **3. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme**

Kuvendi e miratoi procesverbalin e mbledhjes plenare të mbajtur më 27, 28 mars dhe 3 prill 2014, pa asnjë vërejtje.

**4. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes së kredisë eksportuese e lidhur ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Unicredit Bank Austria AG për financimin e projektit “Modernizimi i sistemit të arsimit të edukimit në Kosovë nëpërmjet e-edukimit”**

Kryetari e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit, të paraqesë dhe arsyetojë Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes së kredisë eksportuese e lidhur ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Unicredit Bank Austria AG për financimin e projektit “Modernizimi i sistemit të arsimit të edukimit në Kosovë nëpërmjet e-edukimit”.

Ministri Besim Beqaj tha se ky projektligj paraqet konkretizimin e parë të Marrëveshjes për bashkëpunim financiar ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Austrisë, nënshkruar më 12 korrik 2012, marrëveshje e cila siguron kredi me kushte të lehta në shumë 20 milion €.

Në vazhdim ai foli për strukturën dhe përmbajtjen në tërësi të projektligjit dhe ftoi deputetët e Kuvendit që ta miratojnë Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes së kredisë eksportuese e lidhur ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Unicredit Bank Austria AG për financimin e projektit “Modernizimi i sistemit të arsimit të edukimit në Kosovë nëpërmjet e-edukimit”.

Diskutimi i ministrit Besim Beqaj është dhënë i plotë në transkript.

Pastaj, kryetari hapi debatin për shqyrtimin e këtij projektligji.

Safete Hadërgjonaj, në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa e paraqiti raportin me rekomandime lidhur me shqyrtimin e këtij projektligji.

Për këtë pikë të rendit të ditës nuk pati diskutues tjerë.

Më pas kryesuesi konstatoi se në sallë janë të pranishëm 81 deputetë, ndërsa miratimi i Projektligjit për ratifikimin e marrëveshjes kërkon votën e së paku dy të tretave të deputetëve të Kuvendit.

Kryesuesi e hodhi në votim projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes së kredisë eksportuese e lidhur ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Unicredit Bank Austria AG për financimin e projektit “Modernizimi i sistemit të arsimit të edukimit në Kosovë nëpërmjet e-edukimit”.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për -----80,  
Kundër ----- 0 ,  
Abstenime ----- 1.

Kryesuesi pas verifikimit të një gabimi teknik gjatë votimit në formën elektronike konstatoi se për këtë projektligj kanë votuar: për 79 deputetë, kundër - 0 dhe abstenim - 1 deputet.

Pra, kryesuesi konstatoi se për këtë projektligj duhet të përsëritet procedura e votimit në momentin kur në sallë do të jetë i pranishëm numri i kërkuar i deputetëve.

Sqarimi i kryesuesit, Xhavit Haliti për këtë çështje është dhënë i plotë në transkript.

## **5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës**

Kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës.

Ministri Ramë Buja tha se ky projektligj ka për qëllim krijimin e bazës ligjore për rregullimin, funksionimin, financimin, sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë në përputhje me standardet evropiane si dhe rolin e shtetit dhe të shoqërisë në zhvillimin e arsimit të lartë në Republikën e Kosovës.

Në vazhdim ai foli për strukturën dhe përmbajtjen e këtij projektligji dhe ftoi deputetët për miratimin në parim të këtij projektligji.

Fjala e z. Ramë Buja është dhënë e plotë në transkript.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin në parim të Projektligjit për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Ramë Vataj, në emër të Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media dhe në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Sadri Ferati, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Afrim Kasolli, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Teuta Haxhiu, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; Jeton Svirca, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, Myfera Shinik, në emër të Grupit Parlamentar “6+”, si dhe Hykmete Bajrami, Arsim Bajrami, Haki Demolli, Donika Kadaj-Bujupi, Bekim Haxhiu, Lumnije Morina, Xhafer Tahiri, Aurora Bakalli, Sadri Ferati, Halit Krasniqi, Gëzim Kelmendi, Blerta Deliu-Kodra, Ganimete Musliu, kryeministri Hashim Thaçi dhe ministri Ramë Buja, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Më pas kryetari sqaroi se në bazë të nenit 81 të Kushtetutës të Republikës së Kosovë, për miratimin, ndryshimin ose shfuqizimin e këtij projektligji, kërkohen votat e shumicës së deputetëve të Kuvendit të cilët janë të pranishëm dhe që votojnë, si dhe të shumicës së deputetëve të Kuvendit që janë të pranishëm dhe që votojnë e të cilët mbajnë vende të rezervuara ose të garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve që nuk janë shumicë.

Pra, kërkohen së paku, 13 vota “për” nga deputetët e komuniteteve që nuk janë shumicë.

Në vazhdim kryetari konstatoi se në sallë janë të pranishëm 57 deputetë dhe Kuvendi nuk ka kuorum për të hyrë në procedurën e votimit.

Procedimi me votim bëhet në momentin e plotësimit të kuorumit.

## **6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërmarrjet publike**

Kryetari e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërmarrjet publike.

Ministri Dardan Gashi foli për strukturën dhe përmbajtjen e këtij projektligji dhe ftoi deputetët për miratimin në parim të këtij projektligji.

Fjala e z. Dardan Gashi është dhënë e plotë në transkript.

Pastaj, kryetari e hapi debatin për shqyrtimin në parim të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërmarrjet publike.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Fikrim Damka, në emër të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri; Sala Berisha-Shala, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Lutfi Zharku - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Faton Topalli - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Donika Kadaj-Bujupi, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, si dhe Albin Kurti, Sadri Ferati, Sala Berisha-Shala dhe ministri Dardan Gashi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim projektligjin.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për -----45,  
Kundër ----- 10 ,  
Abstenime -----6.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 04/L-270 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërmarrjet publike.

#### **7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për kinematografinë**

Kryetari e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për kinematografinë.

Në emër të Qeverisë askush nga Kabineti qeveritar nuk u paraqit për të paraqitur dhe arsyetuar projektligjin.

Kryetari konstatoi se Projektligji për kinematografinë i kthehet Qeverisë, me arsyetimin se askush nga Kabineti qeveritar nuk u paraqit për ta arsyetuar projektligjin.

#### **8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për sigurimin shëndetësor**

Kryetari i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit FunkSIONAL raportues për Projektligjin për sigurimin shëndetësor.

Kryetari më pas i hodhi në votim amendamentet, veç e veç.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 34, 35, 36, 37, 38, 39, 40, 41, 42, 43, 44, 45, 46, 47, 48, 49, 50, 51, 52, 53, 54, 55, 56, 57, 58, 59, 60, 61, 62, 63, 64, 65, 66, 67, 68, 69, 70, 71, 72, 73, 74, 75, 76, 77, 78 dhe 79.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për -----63,  
Kundër ----- 0 ,  
Abstenime ----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 04/L-249 për sigurimin shëndetësor.

## **9. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për arsimin e lartë të Republikës së Kosovës**

Kryetari i njoftoi deputetët për raportin me rekomandimet të Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për arsimin e lartë të Republikës së Kosovës.

Deputetja Teuta Haxhiu, në emër të Komisionit Funkcional, paraqiti dhe arsyetoi para deputetëve raportin me rekomandime lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për arsimin e lartë të Republikës së Kosovës.

Diskutimi i deputetes Teuta Haxhiu është dhënë i plotë ne transkript.

Kryetari hapi debatin për shqyrtimin e raportit të lartpërmendur.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Xhevahire Izmaku, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Sadri Ferati, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Afrim Kasolli, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Teuta Haxhiu, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, ndërsa Jeton Svirca, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, si dhe ministri Ramë Buja, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas diskutimeve kryetari e hodhi në votim miratimin e raportit të lartpërmendur.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për -----56,  
Kundër ----- 0 ,  
Abstenime ----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi nuk e miratoi raportin me rekomandime të Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 04/L-037 për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës, me arsyetim se në votim nuk kanë marrë pjesë së paku 61 deputetë, në mënyrë që vendimmarrja të jetë e vlefshme.

\* \* \*

Në vazhdim kryesuesi konstatoi se Kuvendi përfundoi punimet për ditën e sotme, ndërsa vazhdimin e punimeve të kësaj mbledhje plenare e paralajmëroi për 11 prill 2014, në orën 10:00.

\* \* \*

Kryesuesi i mbylli punimet e mbledhjes së sotme në orën 17:20 minuta.

\* \* \*

***11 prill 2014***

***Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 7 prill 2014***

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, Jakup Krasniqi, ndërsa i ndihmoi nënkryetari i Kuvendit, Xhavit Haliti.

Kryetari deklaroi të hapur vazhdimin e punimeve të mbledhjes plenare të filluar më 10 prill 2014.

Ai procedoi me pikat, si në vijim:

***4. Votimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes së kredisë eksportuese e lidhur ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Unicredit Bank Austria AG për financimin e projektit “Modernizimi i sistemit të arsimit të edukimit në Kosovë nëpërmjet e-edukimit”***

Kryetari konstatoi se në sallë janë të pranishëm 62 deputetë dhe Kuvendi nuk ka kuorum për të proceduar me votim të këtij projektligji.

***5. Votimi i parë i Projektligjit për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës***

Kryetari konstatoi se Kuvendi nuk ka kuorum për të proceduar me votim për këtë projektligj ashtu siç kërkohet në nenin 81, amendamenti 2 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës.

***10. Shqyrtimi i raportit vjetor të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për vitin 2013***

Deputeti Ramë Vataj, në emër të Komisionit Funkcional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media tha se si komision e kemi shqyrtuar raportin vjetor të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për vitin 2013 dhe kemi rekomanduar shqyrtimin dhe miratimin në mbledhje plenare.

Ai në fund e përkrahu raportin vjetor të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për vitin 2013.

Fjala e z. Ramë Vataj është dhënë e plotë në transkript.

Kryetari e hapi debatin lidhur me këtë pikë të rendit të ditës.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Xhevahire Izmaku, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Sadri Ferati, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Afrim Kasolli, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Teuta Haxhiu, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, ndërsa Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, Safete Hadërgjonaj, në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, si dhe Lirije Kajtazi, Xhafer Tahiri, Salih Morina dhe Jakup Krasniqi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas diskutimeve kryetari hodhi në votim Raportin e lartpërmendur.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për -----69,  
Kundër ----- 0 ,  
Abstenime ----- 1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi miratoi raportin vjetor të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për vitin 2013.

### **11. Shqyrtimi i propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e kryesuesit dhe anëtarëve të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës**

Kryetari e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë propozim-vendimin për emërimin e kryesuesit dhe anëtarëve të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Në emër të Qeverisë askush nga Kabineti qeveritar nuk u paraqit për ta arsyetuar propozim-vendimin për emërimin e kryesuesit dhe anëtarëve të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Kryetari konstatoi se kjo pikë e rendit të ditës shtyhet.

### **12. Shqyrtimi i propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Shkencës**

Deputeti Ramë Vataj, në emër të Komisionit Funkcional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media tha se si komision e kemi shqyrtuar propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Shkencës dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim në mbledhje plenare.

Fjala e z. Ramë Vataj është dhënë e plotë në transkript.

Kryetari e hapi debatin lidhur me këtë pikë të rendit të ditës.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Ramë Vataj, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Afrim Kasolli, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Teuta Haxhiu, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, ndërsa Jeton Svirca, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, Albert Kinolli, në emër të Grupit Parlamentar “6+”, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas diskutimeve kryetari hodhi në votim Propozim-vendimin e lartpërmendur.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për -----48,  
Kundër ----- 1 ,  
Abstenime ----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi nuk e miratoi propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Shkencës, me arsyetim se në votim nuk kanë marrë pjesë së paku 61 deputetë, në mënyrë që vendimmarrja të jetë e vlefshme.

### **13. Emërimi i anëtarëve të Këshillit Drejtues të Institutit Gjqësor të Kosovës**

Deputeti Arben Gashi, në emër të Komisionit Funkcional për Legjislacion tha se si komision e kemi shqyrtuar propozimin për emërimin e anëtarëve të Këshillit Drejtues të Institutit Gjqësor të Kosovës dhe Kuvendit i kemi rekomanduar miratimin e tij.

Fjala e z. Arben Gashi është dhënë e plotë në transkript.

Kryetari e hapi debatin lidhur me këtë pikë të rendit të ditës.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Behar Selimi, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; ndërsa Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas diskutimeve kryetari hodhi në votim Propozim-vendimin e lartpërmendur.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për -----48,  
Kundër ----- 0 ,  
Abstenime ----- 2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi nuk e miratoi propozimin e kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës dhe Shoqatës së Prokurorëve të Kosovës, për emërimin e anëtarëve të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës, me arsyetim se në votim nuk kanë marrë pjesë së paku 61 deputetë, në mënyrë që vendimmarrja të jetë e vlefshme.

#### **14. Emërimi i anëtarit të Komisionit për Kërkesa Pronësore**

Deputeti Arben Gashi, në emër të Komisionit Funkcional për Legjislacion tha se si komision e kemi shqyrtuar propozimin e kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës për emërimin e një anëtari në Komisionin për Kërkesa Pronësore dhe kemi rekomanduar miratimin e tij.

Fjala e z. Arben Gashi është dhënë e plotë në transkript.

Kryetari e hapi debatin lidhur me këtë pikë të rendit të ditës.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Halit Krasniqi - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; kurse Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas diskutimeve kryetari hodhi në votim Propozimin e lartpërmendur.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 61,  
Kundër ----- 6,  
Abstenime ----- 1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi mori këtë:

#### **V E N D I M**

1. Adem Vokshi emërohet anëtar i Komisionit për Kërkesa Pronësore, me mandat një (1) vjeçar.

#### **15. Zgjedhja e një anëtari të Komisionit të Pavarur për Media**

Kryetari i informoi deputetët se Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media, ka shqyrtuar nominimet e kandidatëve për anëtar të Komisionit të Pavarur për Media, dhe Kuvendit i ka paraqitur rekomandimin për miratim.

Arsyetimin e raportit me rekomandime në emër të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media e paraqiti deputetja Xhevahire Izmaqi.

Më tej, kryetari sqaroi se për zbatimin e procedurës së votimit të fshehtë, kërkohet krijimi i një komisioni votues nga përbërja e deputetëve, me mbështetje të zyrtarëve të administratës dhe fitoi përfaqësuesit e grupeve parlamentare, që të propozojnë nga një anëtarë për Komisionin votues.

Grupet parlamentare propozuan këta anëtarë:

1. GP PDK - Ramë Vataj,
2. GP LDK - Armend Zemaj,
3. GP Vetëvendosje - Albana Gashi,
4. GP AAK - Teuta Haxhiu,
5. GP - Koalicioni Kosova e Re - Sevdije Lama,
6. G/P- "6+" , Fikrim Damka.

Kuvendi miratoi emërimin e anëtarëve në Komisionin votues.

Në vazhdim deputetët u ftuan një nga një për të votuar.

Pas numërimit të fletëvotimeve, në emër të Komisionit votues, raportin e paraqiti Ramë Vataj. Ai konstatoi se në votim morën pjesë 83 deputetë, ndërsa të pavlefshme janë 6 fletëvotime.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Albana Beqiri ka fituar 26 vota, ndërsa Abit Hoxha ka fituar 51 vota.

Ai konstatoi se në bazë të rezultatit të votimit për zgjedhjen e anëtarit të Komisionit të Pavarur për Media, nga radhët e komunitetit shumicë shqiptar, Abit Hoxha, zgjedhet anëtar i këtij Komisioni.

Kryetari konstatoi se mandati i anëtarit të Komisionit të Pavarur për Media, caktohet me short, pas zgjedhjes nga Kuvendi i Kosovës.

Aktualisht kanë mbetur një pozitë për mandat dy vjeçar dhe dy pozita për mandat trevjeçar.

Kryesuesi i mbylli punimet e mbledhjes së sotme në orën 12:15 minuta.

\* \* \*

***17 prill 2014***

***Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 10 e 11 prill 2014***

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, Jakup Krasniqi, ndërsa i ndihmoi nënkryetari i Kuvendit, Sabri Hamiti.

Kryetari deklaroi të hapur vazhdimin e punimeve të mbledhjes plenare të filluar më 10 prill 2014 dhe procedoi me pikat, si në vijim:

#### **4. Votimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes së kredisë eksportuese e lidhur ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Unicredit Bank Austria AG për financimin e projektit “Modernizimi i sistemit të edukimit në Kosovë nëpërmjet e-edukimit”**

Kryetari tha se diskutimet për këtë pikë të rendit të ditës kanë përfunduar në seancën plenare me 10 prill 2014, mirëpo në mungesë të kuorumit, procedimi me votim është shtyer.

Ai më tej sqaroi se miratimi i këtij projektligji kërkon së paku 80 vota “për” dhe i nënshtrohet vetëm një shqyrtimi.

Ai konstatoi se në sallë janë të pranishëm 83 deputetë.

Më pas kryetari hodhi në votim Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes së kredisë eksportuese e lidhur ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Unicredit Bank Austria AG për financimin e projektit “Modernizimi i sistemit të edukimit në Kosovë nëpërmjet e-edukimit”.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 80,  
Kundër----- 0,  
Abstenime----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, mori këtë:

#### **V E N D I M**

1. Miratohet Ligji nr.04/L-271 për ratifikimin e Marrëveshjes së kredisë eksportuese e lidhur ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Unicredit Bank Austria AG për financimin e projektit “Modernizimi i sistemit të arsimit të edukimit në Kosovë përmes e-edukimit”.
2. Ligji i dërgohet Presidentes së Republikës së Kosovës, për shpallje.

#### **5. Votimi i Projektligjit për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës**

Kryetari tha se diskutimet për këtë pikë të rendit të ditës kanë përfunduar, në seancën plenare me 10 prill 2014, mirëpo në mungesë të kuorumit, procedimi me votim është shtyer.

Më pas kryetari sqaroi se duke u bazuar në nenin 81, amendamenti 2, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës: “Për miratimin, ndryshimin ose shfuqizimin e ligjeve në vijim, kërkohet vota e shumicës së deputetëve të Kuvendit dhe të shumicës së deputetëve të Kuvendit, të cilët mbajnë vendet e garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve që nuk janë në shumicë”.

Pra, nevojiten 61 vota “për” përfshirë këtu 13 vota të komuniteteve tjera.

Kryetari konstatoi se në sallë mungojnë deputetët nga komuniteti serb, andaj procedimi me votim për këtë pikë nuk mund të bëhet.

Ai konstatoi se kjo pikë e rendit të ditës do të procedohet për votim në seancën e radhës, në momentin e plotësimit të kuorumit të nevojshëm.

## **11. Shqyrtimi i propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e kryesuesit dhe anëtarëve të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës**

Ministri Bernard Nikaj, paraqiti dhe arsyetoi para Kuvendit propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e kryesuesit dhe anëtarëve të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Fjala e z. Bernard Nikaj është dhënë e plotë në transkript.

Deputeti Zenun Pajaziti, në emër të Komisionit FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, tha se si komision e kemi shqyrtuar propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e kryesuesit dhe anëtarëve të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe kemi rekomanduar miratimin e tij.  
Fjala e z. Zenun Pajaziti, është dhënë e plotë në transkript.

Kryesuesi Sabri Hamiti e hapi debatin lidhur me këtë pikë të rendit të ditës. Nuk pati deputetë të paraqitur për diskutim.

Kryesuesi më pas hodhi në votim propozim-vendimin e lartpërmendur.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 36,  
Kundër ----- 7,  
Abstenime ----- 1.

Kryesuesi konstatoi se për këtë pikë të rendit të ditës mungon kuorumi për vendimmarrje.

Kryetari i Kuvendit

**Jakup KRASNIQI**

*Procesmbajtës:*

*Selman Ymeri, zyrtar i lartë ligjor*